

DIMENSIONI FORMUES I SHKËMBIMEVE NDËRKULTURORE NË SISTEMIN ARSIMOR SHQIPTAR

Dhurata HOXHA

Departamenti i Romanistikës

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti "L.Gurakuqi", Shkodër

SHQIPËRI

E-mail: *hoxhadhur2000@yahoo.it*

PËRMBLEDHJE

Formimi i qytetarit të mijëvjeçarit të ri përbën qëllimin final të arsimit në Shqipëri. Shumë vëmendje po i kushtohet mësimdhënies së gjuhëve të huaja, si mjaft të rëndësishme në komunikimin ndërshtetëror dhe ndërkulturor. Pasqyrimi në dokumentet zyrtarë të MASH-it i parimeve europiane të edukimit; projektet mbi edukimin me ndjenjën e paqes, tolerancës, qytetarisë europiane; përmirësimi i kurrikulave të gjuhëve të huaja; botimi i teksteve të reja mësimore përbëjnë arritje pozitive. Mirëpo, në stadin aktual të zhvillimit, kur flitet gjithnjë e më shumë për ndërkombëtarizim të shkëmbimeve në çdo fushë, mbështetja e tërësisë së mësimdhënies së gjuhëve të huaja të shkëmbimet ndërkulturore është një mjet radikal për sistemin arsimor shqiptar për t'u përafëruar me sistemet e përparuara europiane dhe një mobilitet brenda tyre, për të realizuar një njohje më të thellë të të Tjerëve dhe vetvetës, për ta bërë të njohur Shqipërinë në arenën ndërkombëtare.

Fjalët kyçe: njohje, shkëmbim, mobilitet, formim

ABSTRACT

The formation of the new millennium citizen constitutes the final aim of the education in Albania. Close attention is being paid to the teach-

ing of foreign languages, as too important for the intercultural and interstate communication. The presentation of the European educational principles in the official documents of The Ministry of Education and Science, the projects on the nourishing of the peace feeling, tolerance and European citizenship, the improving of Foreign Language curricula, the publication of new textbooks constitute positive achievements. At the present stage of development, while it is frequently spoken about the internationalization of exchanges in every field, the support of the totality of foreign language teaching in intercultural is a main means or the Albanian educational system in order to approach to European systems and to obtain some more profound knowledge of Others and oneself, in order to make Albania known worldwide.

Promovimi i dimensionit europian në arsim është kthyer tashmë në një leitmotiv si për organizmat përgjegjëse të edukimit ashtu edhe për aktorët e këtij procesi (përgjegjës politikë e shtetërorë, mësues, nxënës, drejtues apo specialistë të arsimit) dhe synon forcimin e identitetit europian nëpërmjet njohjes dhe respektit reciprok, edukimin me ndjenjën e qytetarisë europiane, ndërgjegjësimin për sfidat e përbashkëta poli-

tiko-shoqërore. Në këtë kontekst, një vëmendje e veçantë po i kushtohet shkëmbimeve ndërkulturore duke i konsideruar si mjaft të rëndësishme “në zhvillimin e një solidariteti midis shtetasve europianë dhe forcimin e një Europe që ofron mundësi për të gjithë si për të tashmen ashtu edhe për të ardhmen” [1].

Edhe sistemi arsimor shqiptar, po përballet me sfida të rëndësishme që kanë për qëllimin final formimin e qytetarit të mijëvjeçarit të ri, përgatitjen e të rinjve tanë për të njohur më mirë, për të ndërvepruar e shkëmbyer me përvojën europiane dhe më gjerë.

Po, si mund të arrihet ky qëllim? Sa dhe si mund të ndikonin shkëmbimet ndërkulturore dhe a mund të ishin ato të realizueshme për realitetin shqiptar?

1. PËRMBAJTJA E SHKËMBIMEVE NDËRKULTURORE NË FUSHËN E EDUKIMIT

1.1. Përkufizimi teorik dhe konceptimi praktik

Duke iu referuar shumë dokumentave zyrtare të Këshillit të Europës dhe Komisionit Europian, shkëmbimet ndërkulturore në fushën e edukimit përfaqësojnë një “takim që bën të mundur një ndarje të përvojave të ndryshme shkollore, kulturore dhe emocionale duke favorizuar pranimin e dallimeve dhe kuptimin e një tjetër universi.” Si të tilla, ato konsiderohen:

- Një mjet për të arritur mirëkuptimin ndërkombëtar dhe krijimin e një ndërgjegjeje europiane duke synuar një njohje reciproke midis vendeve dhe popujve europianë si dhe paqe e stabilitet midis tyre;

- Një mjet që favorizon transferimin e dijeve dhe teknologjive nga një vend në tjetrin duke kontribuar në zhvillimin reciprok;

- Një instrument formimi që ndihmon në përfundimin e aftësive ndërkombëtare (përvetësimin e gjuhëve të huaja / aftësive ndërkulturore) si dhe atyre personale [2].

1.2. Objektivat

Që nga momenti kur shkëmbimet u shfaqën për herë të parë e deri në ditët e sotme, në kulmin e lulëzimit të tyre, mund të thuhet me plot bindje se ato i kanë zgjeruar shumë objektivat.

Objektivat e përgjithshme:

Forcimi i mirëkuptimit dhe respektit për diversitetin midis njerëzve dhe kulturave; edukimi me ndjenjën e tolerancës dhe paqes;

Përmirësimi i TIK (Teknologjive të Informimit & Komunikimit), meqenëse shumë forma të shkëmbimeve kryhen me anë të këtyre teknologjive [3].

Objektivat specifike:

1.2.1. Objektivat gjuhësore.

Përforcimi i motivimit për mësimin e gjuhëve të huaja, përmirësimi i aftësive komunikuese, në mënyrë që nxënësit të mësojnë jo vetëm për të arritur një rezultat pozitiv në këto lëndë, por për t'i përdorur njohuritë gjuhësore në situata reale të shkëmbimeve gjuhësore, duke i transformuar ato nga lëndë shkollore të zakonshme, në një instrument të vërtetë komunikimi.

1.2.2. Objektivat pedagogjike

Në planin e shkollës shqiptare, ato do të sillnin përvojë të përparuar europiane dhe shpeshherë mund të çonin në rishikim e përmirësim të kurrikulave shkollore dhe programeve lëndore; do të zhvillonin mundësinë për të mësuar së bashku duke shkëmbyer mendime e pikëpamje dhe duke zënë miq.

Në planin e përmbajtjes edukative, takimi me Tjetrin do të përbente në të njëjtën kohë një pasurim, duke realizuar njohjen e Tjetrit dhe sistemit të tij edukativ, njohjen e thellë të vetvetes, formimin e vazhdueshëm të të gjithë pjesëmarrësve në shkëmbim, duke kontribuar në formimin e personalitetit të nxënësve; forcimin e besimit në vetvete, tek mësuesi dhe tek tjetri; nxitjen e ndjenjës së mikëpritjes, bujarisë shpirtërore e intelektuale, kapacitetit për të bashkëjetuar [4].

1.2.3. Objektivat socio-kulturore

Shpesh nxënësit mendojnë se të komunikosh do të thotë vetëm të transmetosh informacione. Në të vërtetë të komunikosh, do të thotë të veprosh mbi tjetrin sepse komunikimi është një praktikë shoqërore e rregulluar nga marrëdhënie shoqërore-kulturore që përcaktojnë atë që ka të drejtë t'i thotë dikujt diçka, kurdo dhe në çfarë-dolloj vendi .

Prandaj, gjatë përvojave të shkëmbimeve, nxënësit mund të zhvillojnë aftësitë strategjike (kapacitetin njohës që lejon të ndërhyhet në çdo lloj kërkimi, zgjidhjes të problemeve konkrete); *shoqërore* (vullnetin dhe dëshirën për të filluar një ndërveprim me Tjetrin) dhe *kulturore* meqenëse gjuha përbën një element shumë të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore që pasqyron evolucionin dhe gjendjen e një shoqërie [5].

2. ZBATIMI I SHKËMBIMEVE NDËRKULTURORE

NË SISTEMIN ARSIMOR SHQIPTAR PARAUNIVERSITAR

2.1. *Analizë e kuadrit institucional.*

Duke vlerësuar një ndër parimet europiane të edukimit “kalimin nga edukimi kulturor në atë ndërkulturor, në të gjitha shoqëritë që ndodhen në periudhë tranzicioni e ndryshimesh të mëdha” [6] në dokumentat e saj zyrtare për arsimin publik shqiptar, MASH-i vë theksin në zbatimin e këtyre parimeve. Meqë shkëmbimet ndërkulturore realizohen në gjuhë të huaj, një vëmendje e veçantë po i kushtohet objektivave socialkulturore që kjo mësimdhënie synon të realizojë:

“Zhvillimin e dijeve, shprehjeve dhe qendrimeve të nxënësve përmes njohjes gjithnjë e më të madhe të aspekteve socialkulturore dhe kulturore të gjuhës së huaj; (...) duke synuar zhvillimin e tolerancës dhe të respektit për diversitetin midis njerëzve dhe kulturave, (...) zhvillimin e ndërgjegjësimit për identitetin kulturor, (...) lehtësimin e shkëmbimeve kulturore dhe lëvizjes midis njerëzve” [7].

Në përmbajtjen e programeve të reja rekomandohet që sensibilizimi kulturor e ndërkulturor të përfshihet në rubrikën e programit tematik nëpërmjet veprimtarive të jetës së përditshme, botës së arsimit, trajnimit apo punës, për të vazhduar më tej me përvojat individuale të qendrimit jashtë shtetit (p.sh. vizitat turistike, shkëmbimet familjare, shkollore) si dhe çështje të tjera të rëndësishme ndërkombëtare si (bashkëpunimi e konflikti, qytetaria europiane e botërore, emigrimi dhe imigrimi, përvoja e jetës si mërgimtar etj).

Pas botimit të *Kurrikulës kombëtare të gjuhëve moderne për arsimin publik parauniversitar* u bënë përpjekje për të botuar tekste shkollore të gjuhëve të huaja dhe disiplinave të tjera të ciklit të lartë të

shkollës 9-vjeçare dhe të mesme, të cilat sjellin përmirësime të ndjeshme në pasqyrimin e aspekteve kulturore por edhe të dimensionit ndërkulturor. Në këto tekste hasen forma të ndryshme të shkëmbimeve shkollore midis të rinjve shqiptarë e bashkëmoshatarëve të tyre europianë, si korrespondencë me anë të letrave apo postës elektronike, shkëmbime materiale madje edhe udhëtime konkrete në vendet respektive.

Nga ana tjetër, janë botuar edhe materiale mbi edukimin ndërkulturor, madje janë hartuar edhe projekte si “Edukimi ndërkulturor dhe i të drejtave të njeriut në shkollë” duke përfshirë në edukimin me ndjenjën e paqes, tolerancës dhe qytetarisë europiane, disiplina të ndryshme.

Vitet e fundit, qeveria shqiptare po mbështet fuqimisht pajisjen me Internet të shkollave të sistemit arsimor parauniversitar duke lehtësuar shkëmbimet e të rinjve tanë me bashkëmoshatarët e tyre europianë e me gjerë.

Mirëpo, megjithëse teorikisht flitet për shkëmbimet ndërkulturore si një ndër aspektet kryesore të realizimit të edukimit me ndjenjën e tolerancës, paqes dhe mirëkuptimit midis njerëzve, praktikisht, veçanërisht shkëmbimet konkrete paraqiten të porealizueshme për realitetin shqiptar.

Përvoja të tilla hasen edhe në Shqipëri por:

Së pari, janë iniciativa personale dhe sporadike të mësuesve apo të drejtuesve duke shfrytëzuar njohje personale me partner të huaj;

Së dyti, paraqiten si privilegj i mësuesve dhe nxënësve të kryeqytetit e qyteteve të mëdha, ku ekzistojnë tashmë kontakte me partnerët europianë, në sajë të projekteve rajonale, në fusha të ndryshme apo binjakëzimeve të realizuara në këtë kuadër, ku edhe motivimi për mësimin e gjuhëve të huaja është më i madh;

Së treti, mbeten të panjohura për pjesën e madhe të mësuesve dhe nxënësve, meqë pjesëmarrësit në këto shkëmbime kënaqen më shumë me përvojën e jetuar sesa me jehonën që këto shkëmbime duhet të kenë pranë mësuesve dhe nxënësve të tjerë në veçanti e komunitetit në përgjithësi.

Për realitetin shqiptar, vlera e tyre nuk njihet deri në atë shkallë sa të shndërrohen në një përvojë nga e cila mund të përfitohet shumë.

2.2. Vështirësitë në realizimin e shkëmbimeve ndërkulturore.

2.2.1. Vështirësi me karakter institucional e financiar.

Me Traktatin e Mastrohtit u hap një fazë e re bashkëpunimi edhe në sistemin edukativ për të gjitha vendet e Bashkimit Europian. Këshilli i Europës dhe Komisioni Europian propozuan si pikë referuese për një veprim më të gjerë në këtë sektor, funksionimin e projekteve të mëdha të bashkëpunimit me qëllim ndërgjegjësimin ndaj diversitetit kulturor dhe kapërcimin e disa kufizimeve si pasojë e këtij diversiteti kulturor. Të gjitha vendet e Bashkimit Europian u përfshinë në programe të shumta si: *Comenius*, që kontriboi në promovimin e një ndërgjegjeje ndërkulturore duke mbështetur edukimin e fëmijëve të emigrantëve apo ciganëve si dhe luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë; *Erasmus*, objektivi kryesor i të cilit ishte mobiliteti në nivel universitar; *Lingua*, që i dha një hov të ri mësimi të gjuhëve të huaja si një domosdoshmëri për shkëmbimet midis vendeve; *Tempus*, për vendet e Europës Lindore, me qëllim njohjen dhe shkëmbimin me kulturat e tyre [8].

Mësuesit dhe nxënësit tanë nuk kanë patur mundësi të përfitojë nga këto projekte (përjashtoj projektin *Tempus*). Edhe rekomandimet dhe vendimet zyrtare në lidhje me edukimin dhe shkëmbimet ndërkulturore nuk janë të shumta dhe kanë ardhur me vonësë në krahasim me vendet perendimore. Institucionet drejtuese merren kryesisht me mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe vendimeve dhe nuk kanë një strukturë përgjegjëse për promovimin dhe mbështetjen e këtyre shkëmbimeve, gjë që bën të vështirë gjetjen e partnerëve të huaj të gatshëm për të pritur nxënësit shqiptarë duke shtuar këtu edhe vështirësitë për gjetjen e burimeve financiare, sidomos kur parashikohen projekte udhëtimesh jashtë vendit.

2.2.2. Formimi i mësuesve.

Është më se e vërtetë se mësuesit tanë paraqesin probleme, sepse nuk zotërojnë një formim sipas pedagogjisë së shkëmbimeve, meqenëse janë formuar në një kohë kur flitej pak ose aspak për

shkëmbimet ndërkulturore; pjesa më e madhe nuk kanë mundësi kontakti me folës vendas apo nuk kanë vizituar asnjëherë vende perendimore; mungojnë programe të formimit të vazhdueshëm me tematikë të tillë.

Realisht pas viteve '90 ka patur një lëvizje të mësimdhënësve tanë sidomos të atyre të të gjuhëve të huaja drejt vendeve perendimore, mundësuar nga bashkëpunimi i Mash-it me Ambasadat e këtyre vendeve në Tiranë, apo me shoqatat dhe organizmat mbështetëse të arsimit në Shqipëri. Por, ka ardhur koha që formimi i mësuesve të bëhet objekt studimi për operatorët pedagogjikë duke diskutuar gjërësisht edhe në shtypin shkencor, në seminare apo konferenca kombëtare, sepse janë pikërisht këta që përgatisin brezin e ri.

2.2.3. Shqipëria është pak e njohur dhe shpeshherë e paragjykuar jashtë vendit.

Duke qenë një vend i vogël, me një histori të gjatë dhe të egër izolimi komunist, Shqipëria nuk njihet shumë nga të rinjtë perendimorë. Nga ana tjetër edhe historia e emigracionit pas viteve 90-të bëri që të shfaqeshin disa stereotipe negative mbi shqiptarët, në ato vende ku këta të fundit punonin dhe jetonin. Kështu që në disa raste, që me vendosjen e kontakteve të para, interesi i institucioneve shkollore perendimore, nxënësve apo familjeve të tyre nuk shkon më tej se sa një kuriozitet fillestar.

Janë shkëmbimet, ato që forcojnë bindjen se, duke iu referuar historisë së vjetër dhe të re, shqiptarët janë një popull me vlera, që dinë të bëjnë miq dhe të ngallin respekt tek të tjerët.

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME KONKRETE

Hartimi dhe zbatimi i një politike arsimore favorizuese ndaj shkëmbimeve, duke ngritur struktura përgjegjëse pranë MASH-it dhe drejtorive rajonale; duke formuar fillimisht operatorë shkëmbimesh, të cilët do të lehtësojnë më vonë projektet e shkëmbimeve ndërkulturore si dhe duke përfshirë në sistemin kualifikues kombëtar përvoja të këtyre shkëmbimeve.

Promovimi i dimensionit formues të shkëmbimeve në kuadrin e edukimit me ndjenjën e tolerancës, paqes dhe mirëkuptimit midis njerëzve duke përgatitur materiale divulgative në ndihmë

të drejtuesve, mësuesve dhe nxënësve.

Bashkëpunimi me kolegë të disiplinave të tjera (historisë, sociologjisë, gjeografisë) sidomos kur në mësimdhënien e gjuhëve të huaja diskutohet për trashëgiminë kulturore.

Hartimi i projekteve të shkëmbimeve konkrete, të cilat motivojnë shumë nxënësit të mësojnë gjuhët e huaja, që nuk kanë pasur mundësi t'i praktikojnë jashtë saj; të njohin nga afër vende dhe kultura të tjera për të cilat kanë pasur ndoshta ide të paqarta dhe plot stereotipe; të takojnë bashkëmoshatarë njëherësh të ngjashëm dhe të ndryshëm me ta.

Si përfundim, këto shkëmbime ndihmojnë të rinjtë tanë të zbulojnë horizonte të reja; të përfitojnë pjekuri më të madhe dhe një vizion të qartë për botën së cilës i përkasin si të barabartë dhe të ndryshëm; të shndërrohen në "ambasadorë" të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

BIBLIOGRAFIA

1-2. Commission européenne, (1996) *Livre vert. Les obstacles à la mobilité transnationale*, Luxembourg: Office des publications officielles des communautés européennes, 1-5 [1-2].

BEACCO J.C., BYRAM M. (2003) *Guide pour l'élaboration des politiques linguistiques éducatives en Europe*. De la diversité linguistique à l'éducation pluri-lingue, Division des politiques linguistiques, Conseil de l'Europe, Strasbourg [8].

BYRAM M., ZARATE G., NEUNER G. (1997) *La compétence socioculturelle dans l'apprentissage et l'enseignement des langues*, Editions du Conseil de l'Europe, Strasbourg, 76 [4-5].

MASH (autorë të ndryshëm), (2000) *Kurrikula kombëtare e gjuhëve moderne për arsimin publik parauniversitar*, Toena, 10-11 [7].

PALOMBA D. (1998) *L'interculturale oggi e il ruolo degli scambi educativi*, LEND, La nuova Italia, 22-27 [3].

RILEY P. (1989) *Social identity and intercultural communication*, Levende Talen, Nr. 443, 67-72 [6].